



Republika e Shqipërisë

**Strategjia Kombëtare
e Personave me Aftësi të Kufizuara**

Pasqyra e lëndës

Falënderim	fq. 3
Hyrje	fq. 4
Përkufizimi i ri i Aftësisë së Kufizuar	fq. 6
Parimet themelore të Strategjisë	fq. 6
Objektivat	fq. 7
Analiza e situatës së personave me aftësi të kufizuara në Republikën e Shqipërisë	fq.10
• Të dhëna statistikore	fq. 10
• Vlerësimi i Aftësisë së Kufizuar	fq. 11
• Kuadri ligjor për Personat me Aftësi të Kufizuara në Shqipëri	fq. 13
Shërbimet rehabilituese dhe integruese	fq. 13
Fushat e Ndërhyrjes / Plani i Veprimit	fq. 20
• Jetesa pa barriera	fq. 21
• Shërbimet	fq. 22
• Punësimi, Formimi profesional dhe Arsimimi	fq. 23
• Ngritja e kapaciteteve	fq. 24
• Kuadri ligjor dhe puna kërkimore	fq. 24
Struktura e Monitorimit dhe Raportimit për Strategjinë Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara.....	fq. 26
Plani i veprimit për Strategjinë Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara (shtojcë)	

Falënderim

Hartimi i Strategjisë Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara është mbështetur mbi kontributin e një numri të madh individësh, grupesh dhe organizatash. Falënderojmë institucionet dhe organizatat e mëposhtme për ndihmesën dhe pjesëmarrjen:

- Grupi ndërmintor i punës për hartimin e Strategjisë Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara, i përbërë nga përfaqësues të institucioneve të mëposhtme:

Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale (kryesuese e grupit të punës)
Shërbimi Social Shtetëror
Instituti i Sigurimeve Shoqërore
Shërbimi Kombëtar i Punësimit
Ministria e Drejtësisë
Ministria e Shëndetësisë
Ministria e Arsimit dhe Shkencës
Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit
Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
INSTAT
Bashkia e Tiranës
Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Aftësisë së Kufizuar

- Shoqata Kombëtare e të Verbërve të Shqipërisë
- Shoqata Kombëtare e Invalidëve të Punës së Shqipërisë
- Shoqata Kombëtare e Personave që nuk dëgjojnë
- Shoqata Kombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuar mendore
- Shoqata Kombëtare e Grave me Aftësi të Kufizuara të Shqipërisë
- Shoqata Kombëtare e Para dhe Tetraplegjikëve të Shqipërisë
- Shoqata Kombëtare e Hemofilisë

- Shoqata “Ndihmoni Jetën”
- Shoqata MEDPAK, Librazhd
- Shoqata e Krijuesve të Talentuar me Aftësi të Kufizuara
- Shoqata e Pavarur për Kujdesin e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar Mendore
- Shoqata Gruaja dhe Fëmijët me Aftësi të Kufizuara
- Shoqata “Dashuri për Jetën” në ndihmë të të sëmurëve tumoralë
- Shoqata “Dashuri dhe Shpresë” në ndihmë të para dhe tetraplegjikëve
- Shoqata e Personave me Aftësi të Kufizuara, Kavajë

- Zyra e Komisionerit të Lartë Federal për Çështje të Personave me Aftësi të Kufizuara, Ministria Federale e Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale, Republika Federale e Gjermanisë

- Prezenca e OSBE në Shqipëri

Hyrje

Ne jetojmë në një shoqëri e cila nuk është plotësisht e hapur ndaj personave me aftësi të kufizuara. Strategjia Kombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuara paraqet një plan për ta ndryshuar këtë gjendje.

Aftësia e kufizuar nuk qëndron te individi; ajo që ka individi është dëmtimi. Dëmtimet mund të jenë të natyrës fizike, ndijore, neurologjike, psikiatrike, intelektuale apo të një natyre tjetër.

Aftësia e kufizuar ndjehet më shumë kur një grup njerëzish ngrënë barriera dhe krijojnë pengesa duke planifikuar ndërtimin e një bote vetëm për veten e tyre, duke mos marrë parasysh dëmtimet që kanë pësuar bashkëqytetarët e tjerë. Shoqëria shqiptare, ashtu si dhe shoqëri të tjera, është e krijuar mbi supozimin se të gjithë njerëzit, pa përjashtim, mund të lëvizin shpejt në rrugë, mund të shohin shenjat, të lexojnë udhëzimet, të dëgjojnë lajmërimet, të shtypin butonat, të kenë forcë të mjaftueshme për të hapur dyer të rënda si dhe të perceptojnë dhe të ndërveprojnë në mënyrë standarde me mjedisin.

Aftësia e Kufizuar lidhet me ndërveprimin midis personit të dëmtuar dhe mjedisit që e rrethon atë. Aftësia e Kufizuar ka shumë pikëprerje me diskriminimin dhe është e ngjashme me sjellje të tjera, siç janë racizmi dhe seksizmi, të cilat nuk janë të pranueshme në shoqëri.

Njerëzit dhe grupet e njerëzve nuk mund dhe nuk duhet të paragjykoen nisur nga një aspekt i veçantë i jetës së tyre – qoftë kjo raca, gjinia, mosha apo dëmtimi. Praktikant e përdorura nga shumë institucione, nuk u mundësojnë njerëzve me aftësi të kufizuara të kenë qasje dhe të kryejnë ato veprime të cilat njerëzit e tjerë mund t'i kryejnë me siguri.

Dëshira për të hequr pengesat që shkaktojnë aftësinë e kufizuar lidhet ngushtësisht me idenë e të drejtave të njeriut dhe të njerëzve që kanë pësuar dëmtime. Askush nuk mund të jetojë si qenie njerëzore me të drejta të plota, nëse mungojnë të drejtat dhe liritë e tij.

Njerëzit me aftësi të kufizuara gëzojnë të drejta të njëjta me të gjithë qytetarët e tjerë. Neni i parë i Deklaratës Universale mbi të Drejtat e Njeriut përcakton: "Të gjithë njerëzit janë të lirë dhe të barabartë në dinjitet dhe të drejta". Në mënyrë që të arrihet ky qëllim, të gjitha komunitetet duhet të respektojnë ndryshimet brenda komunitetit të tyre dhe duhet të bëjnë të mundur që personat me aftësi të kufizuara të gëzojnë të drejtat e njeriut: civile, politike, shoqërore, ekonomike dhe kulturore të njohura nëpërmjet konventave dhe traktateve ndërkombëtare, Deklaratës së Madridit dhe kushtetutave kombëtare.

Përveç Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, ekzistojnë gjashtë konventa themelore mbi të drejtat e njeriut që lidhen me të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike (KNDCP) dhe Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore (KNDESHK), e ratifikuar në vitin 1966, janë dy traktatet kryesore të të drejtave të njeriut dhe së bashku me Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut përbëjnë Dokumentin Ndërkombëtar të të Drejtave. Katër konventat e tjera kryesore janë Konventa Kundër Torturës dhe Dhunës, Trajtimin apo Ndëshkimin Çnjerëzor dhe Poshtëruës (1949); Konventa mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (1979); Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve (1989); dhe Konventa Ndërkombëtare mbi Mënjanimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racial (1966). Gjashtë konventat që përcaktojnë parimet e mosdiskriminimit dhe traktatet e përmendura së fundi përcaktojnë të drejtat e përgjithshme të shprehura në KNDCP dhe KNDESHK. Dispozitat mbi mosdiskriminimin në KNDCP kanë një kuptim të caktuar mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

Strategjia Kombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuara ka për qëllim të përshkruajë situatën faktike të personave me aftësi të kufizuara në Republikën e Shqipërisë duke nënvizuar prirjet dhe duke përcaktuar objektivat dhe politikat për përmirësimin e situatës së këtyre personave. Gjithashtu, strategjia ka për

qëllim përcaktimin e politikave qeveritare aktive, koordinimin e aktiviteteve të institucioneve shtetërore, individëve dhe organizatave të tjera që punojnë në fushën e Aftësisë së Kufizuar dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Strategjia përfaqëson vullnetin e të gjitha palëve të përfshira në mënyrë që të harmonizojë politikën shqiptare mbi personat me aftësi të kufizuara brenda kuadrit ndërkombëtar të Kombeve të Bashkuara, Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian.

Masat e kësaj strategjie janë konform qëllimeve të Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin Shoqëror dhe Ekonomik (SKZHES) dhe afatet e përcaktuara në Plan Veprimin e Strategjisë do të jenë prioritet i SKZHES për ministrinë. Kështu që masat dhe veprimet e ndërmarra nga ministrinë do të monitorohen jo vetëm nga Struktura për Monitorimin dhe Raportimin mbi Aftësinë e Kufizuar, e përcaktuar në strategji, por gjithashtu edhe nga SKZHES.

Këto struktura monitoruese do të sigurojnë zbatimin e besueshëm të masave aktuale dhe atyre që do ndërmerren në të ardhmen në lidhje me Aftësinë e Kufizuar në Republikën e Shqipërisë.

Strategjia ka për qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës për personat me aftësi të kufizuara në fushën e arsimit, punësimit, shërbimet ndihmëse dhe jetesës pa pengesa. Në këtë mënyrë, strategjia kapërcen hendekun mes Personave me Aftësi të Kufizuar dhe procesit të krijimit të politikave të gjithanshme dhe gjithëpërfshirëse, duke përditësuar të drejtat themelore të personave me aftësi të kufizuar.

Kjo strategji përbën një ndryshim paradigmatic të politikave për personat me aftësi të kufizuara në disa aspekte:

1. Sipas standardeve ndërkombëtare, fokusi i përcaktimit të aftësisë së kufizuar zhvendoset nga arsyeja e dëmtimit në perspektivën e zhvillimit të personave të dëmtuar dhe pjesëmarrjes së tyre të përditshme në jetën shoqërore, si dhe në masat konkrete që duhet të ndërmerren për të shmangur, minimizuar dhe kompensuar këto kufizime. Në të njëjtën kohë, fokusi në politikën që do të ndiqen do të ndryshojë nga Aftësia e Kufizuar në aftësinë dhe kompetencat e personave të dëmtuar.
2. Politikën e aftësisë së kufizuar nuk do të kuptohen më si politika për pakicat, por objektivat e tyre të bazuara në parimet e barazisë, mosdiskriminimit, përfshirjes dhe vetvendosjes do të konsiderohen një pjesë e rëndësishme e një përqsajeje të të drejtave civile ndaj politikës, duke qenë të bindur se këto politika kanë një efekt pozitiv jo vetëm për personat me aftësi të kufizuar, por edhe për grupe të tjera të shoqërisë, si p.sh. të moshuarit. Kjo politikë është një sfidë e gjithë shoqërisë, sepse ajo duhet të konsiderohet si një detyrë e shoqërisë për të ndërtuar struktura që sigurojnë përfshirjen e plotë të personave me aftësi të kufizuara në të gjithat fushat e jetës së përditshme.
3. Shoqatat e personave me aftësi të kufizuara në Shqipëri janë mjaft të përparuara në zhvillimin e tyre strukturor dhe duhet të konsiderohen si faktor i rëndësishëm kompetence. Për më tepër, ato tashmë luajnë një rol të çmuar në disa aktivitete në mënyrë që të rrisin pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në shoqëri. Për këtë arsye kontributi i tyre duhet të institucionalizohet në strukturat monitoruese dhe raportuese të strategjisë.
4. Është e qartë që politika e të drejtave civile nuk ndikon vetëm në fushën politike, shoqërore dhe ekonomike, por ndikon ndjeshëm edhe në politikën në përgjithësi. Prandaj, strategjia do ta pasqyrojë këtë në mënyrë të detajuar dhe do të krijojë një përqsaje tërësore ndaj Personave me Aftësi të kufizuara duke synuar një sistem për përfshirjen e vazhdueshme të Aftësisë së Kufizuar në legjisllacionin shqiptar.

Përcaktimi i ri i Aftësisë së Kufizuar

Në përputhje me terminologjinë e Kombeve të Bashkuara, me konceptet e mundësive të barabarta të personave me aftësi të kufizuara si dhe në përputhje me kategorizimin ndërkombëtar të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH), termi “person me handicap” është zëvendësuar me termin “Person me Aftësi të Kufizuara” (individualisht) dhe “Persona me Aftësi të Kufizuara” (në nivel shoqëror).

Që tani e tutje “Personat me Aftësi të Kufizuara” janë ata persona të cilët funksionet fizike, kapaciteti mendor ose gjendja psikologjike kanë prirje të shmangen për më shumë se gjashtë muaj nga gjendja tipike për moshën përkatëse, gjë që sjell për pasojë kufizime të pjesëmarrjes së tyre në jetën shoqërore.

Ky përcaktim, i cili i përmbahet propozimit të OBSH nuk bazohet në mungesa reale apo të supozuara. Në qendër të vëmendjes vendoset pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuara në fusha të ndryshme të jetës. Një ndryshim nga kushtet normale do të thotë humbje ose kufizime në lidhje me strukturat fizike, mendore apo psikologjike, të cilat janë të pranishme në moshën përkatëse. Aftësia e Kufizuar ekziston në rast se dëmtimi çon në një kufizim, i cili ndikon në pjesëmarrjen në një ose disa fusha të jetës. Kriteri i zgjatjes prej gjashtë muajsh të kufizimit përjashton parregullsitë e përkohshme, të cilat nuk konsiderohen si aftësi e kufizuar, por nuk përjashton ndërhyrjet e menjëhershme që janë të nevojshme në rastet individuale për shmangjen e saj. Kjo ka të bëjë në veçanti me fëmijët tek të cilët është verifikuar aftësia e kufizuar apo rreziku i mundshëm i aftësisë së kufizuar.

Parimet Themelore të Strategjisë

Parimi i të Drejtës Civile, Barazisë dhe Mosdiskriminimit do të thotë që personat me aftësi të kufizuara janë anëtarë të barabartë të shoqërisë; ata mund të kërkojnë të njëjtat të drejta dhe të përfitojnë të njëjtën ndihmë sociale dhe llojet e asistencës si gjithë qytetarët e tjerë; ata nuk duhet të diskriminohen në asnjë fushë të jetës shoqërore. Kjo përfshin ndihmën sociale që i lejon personat me aftësi të kufizuara të jetojnë me dinjitet. Nëse këto parime shkelen, do të ndërmerren veprime ligjore.

Parimi i Vetëvendosjes vjen nga përqasja me të drejtat civile dhe nënkupton që mjedisi ku jetojnë personat me aftësi të kufizuara duhet të ndërtohet në mënyrë të tillë që t'i inkurajojë ata të jetojnë një jetë të pavarur dhe të jenë të aftë të vendosin vetë. Vetëvendosja ka të bëjë gjithashtu me të drejtën për të menaxhuar lëvizjet, kohën dhe pasurinë individuale.

Ky parim gjithashtu parashikon që çdo masë në lidhje me rehabilitimin duhet të ndërmerret në bashkëpunim me personat me aftësi të kufizuara. Ai/ajo nuk duhet të trajtohet asnjëherë pa pëlqimin e tij/saj.

Parimi i Përfshirjes, Pjesëmarrjes dhe Mundësive të Barabarta thekson që personat me aftësi të kufizuara janë tashmë pjesë e shoqërisë, ku ata jetojnë dhe prandaj nuk kanë pse të integrohen, sepse zotërojnë të njëjtat të drejta si njerëzit e tjerë. Për më tepër ata kanë përfitime që i lejojnë ata të marrin pjesë plotësisht në të gjitha fushat e jetës shoqërore, ku përfshihet rehabilitimi mjekësor, pjesëmarrja në jetën në komunitet dhe në punë. Jetesa pa pengesa është një kusht i rëndësishëm për pjesëmarrje.

Parimi i Jetesës pa Barriera dhe Mjedisit të Lirë do të thotë që ndërtesat dhe shërbimet e tjera, mjetet e transportit, pajisjet teknike, sistemet e përpunimit të informacionit, burimet akustike dhe vizuale të shërbimeve informative dhe të komunikimit dhe mjediset e tjera të krijuara konsiderohen pa pengesa (pa barriera), nëse ato zakonisht përdoren nga personat me aftësi të kufizuara, pa vështirësi të veçanta dhe si rregull pa ndihmën e të tjerëve.

Parimet e Parandalimit, Identifikimit dhe Trajtimet të Hershëm kanë të bëjnë me një numër masash që ndërmerren për të evituar sa të jetë e mundur shfaqjen e aftësisë së kufizuar dhe sëmundjeve kronike në të gjitha grupmoshat dhe në të gjitha fushat e jetës. Në këtë aspekt fusha me rëndësi janë mbrojtja e shëndetit, siguria në punë, parandalimi i aksidenteve dhe mbrojtja e mjedisit. Këto parime gjithashtu përfshijnë parandalimin e aftësisë së kufizuar përgjatë fëmijërisë së hershme, nëpërmjet masave siç janë imunizimi etj. Kjo reflekton intuitën që sa më herët të identifikohet në fëmijëri një parregullsi, aq më i mirë dhe i shpejtë do të jetë parandalimi i aftësisë së kufizuar ose trajtimi i suksesshëm i saj. Kjo vlen për të gjitha grupmoshat.

Parimi i Rehabilitimit qëndron në bazë të procesit i cili u siguron personave me aftësi të kufizuara mjetet dhe rrugët për një jetesë të pavarur. Ai ka të bëjë me masat që merren për parandalimin, mënjanimin, lehtësimin apo kompensimin e një aftësie të kufizuar, për parandalimin e përkeqësimit e saj, për nevojën për një kujdes afatgjatë dhe mundësimin e jetës normale për personat me aftësi të kufizuara.

Parimi i Qëllimshmërisë parashikon ndihmën që duhet t'i ofrohet çdo personi me aftësi të kufizuar dhe personave që kanë rrezik të bëhen të tillë, pavarësisht nga shkaku i aftësisë së tyre të kufizuar, edhe nëse përgjegjësia për këtë ndihmë mbahet nga fondet e dhëna nga institucione të ndryshme.

Objektivat

Qëllimi i përgjithshëm i Strategjisë Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara është të sigurojë një përmirësim të dukshëm në statusin dhe cilësinë e jetës së personave me aftësi të kufizuara në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me Standardet e OKB mbi Mundësitë e Barabarta.

Objektivi 1: Inkurajimi dhe edukimi për një shoqëri që mundëson pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara.

- Të mundësohet që personat me aftësi të kufizuara të shërbejnë si specialistë në sektorët e tyre.
- Të njihen dhe të vlerësohen arritjet e personave me aftësi të kufizuara.
- Të përfshihen pikëpamjet e personave me aftësi të kufizuara në debatet etike dhe bioetike.
- Të inkurajohet debati i vazhdueshëm mbi çështjet e aftësisë së kufizuar në Shqipëri.

Objektivi 2: Realizimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.

- Të sigurohet informacion i plotë përsa i përket të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.
- Të sigurohet arsimimi i personave me aftësi të kufizuara në mënyrë që ata të njohin të drejtat e tyre, të njohin diskriminimin dhe të jenë avokatë të vetvetes.
- Të edukohen agjensitë që janë përgjegjëse për mbështetjen e fëmijëve dhe familjeve, për të drejtat dhe mundësitë e prindërve me aftësi të kufizuara.
- Të rishikohet legjislacioni mbi të drejtat e njeriut në mënyrë që të sigurohet vazhdimësia e përmirësimit dhe forcimit të të drejtave të personave me aftësi të kufizuar.
- Të shqyrtohet, e nëse është e nevojshme, të mbështet përmirësimi i Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuar.
- Të shqyrtohet niveli i aksesit që kanë personat me aftësi të kufizuar për të pasur një mbrojtje të pavarur dhe të identifikohen mungesat në dispozitat e shërbimeve.
- Të vlerësohen arritjet e Shqipërisë në fushën e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.

Objektivi 3: Sigurimi i arsimit optimal për personat me aftësi të kufizuara.

- Të sigurohet që asnjë fëmijë të mos i mohohet e drejta për shkollë për arsye të aftësisë së kufizuar.
- Të mbështetet zhvillimi i komunikimit efikas duke krijuar mundësinë për arsimim në gjuhën e shenjave në shqip, teknologjitë e komunikimit dhe mjetet ndihmëse të komunikimit.

- Të mundësohet që mësuesit dhe edukatorët e tjerë të kuptojnë nevojat e mësimit nga studentët me aftësi të kufizuara.
- Të sigurohet që studentët me aftësi të kufizuara, familjet, mësuesit dhe edukatorët e tyre të kenë qasje të mjaftueshme në burimet e disponueshme në mënyrë që të mund të plotësojnë nevojat e tyre.
- Të përmirësohet përgjegjësia e shkollimit të nxënësve me aftësi të kufizuara, të përmbushet detyrimi që ata kanë për nevojat e studentëve me aftësi të kufizuara.
- Të promovohet krijimi i një mjedisi arsimor të përshtatshëm dhe gjithëpërfshirës në mënyrë që të plotësohen nevojat për arsimimin e PAK.

Objektivi 4: Sigurimi i mundësive për punësim dhe zhvillim ekonomik për personat me aftësi të kufizuara.

- Të sigurohet mundësi arsimimi dhe trainimi i personave me aftësi të kufizuara në mënyrë që të rriten kapacitetet e tyre individuale për punësim.
- Të inkurajohen personat me aftësi të kufizuara për të parë mundësinë e trainimit dhe të punësimit të tyre si dhe të marrin pjesë në zhvillimin e mundësive mbështetëse për të arritur këto qëllime.
- Të edukohen punëdhënësit për mundësitë e personave me aftësi të kufizuara për të punuar.
- Të sigurohet informacion për mundësitë e karrierës, mënyrave si të krijojnë të ardhura dhe për ndihmën e nevojshme që duhet t'u jepet personave me aftësi të kufizuara.
- Të shqyrtohen mundësitë e motivimit afatgjatë për të rritur mundësitë e trainimit, punësimit dhe zhvillimit të personave me aftësi të kufizuara.
- Të inkurajohet rritja e mundësive për punësim duke njohur nevojat e ndryshme të njerëzve me aftësi të kufizuara.
- Të sigurohet që personat me aftësi të kufizuara të gëzojnë të njëjtat kushte punësimi, të drejta dhe privilegje, si gjithë të tjerët, duke përfshirë dispozitat për pagesë minimale për punë me prodhimtari të krahasueshme.
- Të sigurohen shërbimet e komunikimit, burimet dhe mundësi të përshtatshme për vendin e punës.
- Të inkurajohet stafi dhe organizatat të emërojnë ose zgjedhin personat me aftësi të kufizuara si delegatë dhe anëtarë të strukturave të tyre.
- Të sigurohet që nevojat e personave me aftësi të kufizuara të merren parasysh në zhvillimin më fleksibël të përfitimeve financiare, për të lehtësuar punësimin, trainimin dhe formimin e tyre profesional.
- Të rishikohen dispozitat e mbështetjes financiare në mënyrë që të sigurohet një standard i pranueshëm jetese.

Objektivi 5: Promovimi i një shërbimi publik të përgjegjshëm dhe transparent ndaj personave me aftësi të kufizuara

- Të krijohen mekanizma për të siguruar që të gjitha politikat qeveritare dhe legjislatoni për PAK të jenë në përputhje me qëllimet e Strategjisë Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara.
- Të përshtatet sektori publik i trainimit / formimit profesional në mënyrë që të sigurohet që zhvillimi dhe shpërndarja e shërbimit të jetë në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara.
- Të sigurohet që të gjitha agjensitë qeveritare t'i trajtojnë personat me aftësi të kufizuara me dinjitet dhe respekt.
- Të përmirësohet cilësia e informacionit që ekziston dhe të orientohen të ineresuarit se ku mund të sigurojnë informacione të tjera, shërbime dhe si mund t'i përfitojnë ato.
- Të krijohet një sistemi i përshtatshëm për metodat e komunikimit dhe informacionit në përputhje me nevojat e personave me aftësi të kufizuara.
- Të sigurohet që vendndodhja dhe ndërtesat e agjensive qeveritare dhe ato të shërbimeve publike të jenë të përdorshme prej tyre.

Objektivi 6: Mbështetja e personave me aftësi të kufizuara për një jetë cilësore në komunitet .

- Rritja e mundësive të personave me aftësi të kufizuara për të jetuar në komunitet duke pasur mundësi për zgjedhje cilësore banimi.
- Mbështetja e personave me aftësi të kufizuar që banojnë në zona rurale, për të jetuar në komunitetin e tyre duke u siguruar ofrimin e një shërbimi të përmirësuar.
- Mbështetje e zhvillimit të komunikimit të pavarur për personat me aftësi të kufizuara.
- Të sigurohet që njerëzit e me aftësi të kufizuara të kenë akses në shërbimet shëndetësore brenda komunitetit të tyre.
- Të sigurohet transport publik i përdorshëm për PAK në mënyrë që të mënjanoen pengesat në lëvizjen e tyre.
- Të inkurajohet heqja e pengesave në ndërtime, në mënyrë që të lehtësohet lëvizja në ndërtesat, hapësirat publike dhe sistemet e transportit.

Objektivi 7: Mbledhja dhe përdorimi i informacionit lidhur me personat me aftësi të kufizuara dhe çështjet e Aftësisë së Kufizuar.

- Të nxitet dhe të krijohet mundësi për punë kërkimore duke marrë parasysh nevojën për studime mbi çështjet e aftësisë së kufizuar, duke përfshirë edhe personat me aftësi të kufizuara në zhvillimin dhe monitorimin e kërkimeve mbi çështjen e aftësisë së kufizuar si dhe të nxiten personat me aftësi të kufizuara të paraqesin përvojat e tyre në kontekstin e këtij kërkimi.
- Të mblidhet informacion sa më i gjerë rreth aftësisë së kufizuar nepërmjet vëzhgimeve dhe programeve kërkimore.
- Të realizohen dhe shfrytëzohen studimet mbi aftësinë e kufizuar dhe analiza e të dhënave mbi të për të përmirësuar politikatat e punës, shërbimit, zhvillimit dhe monitorimit të situatës së saj në Shqipëri.

Analiza e Situatës së Personave me Aftësi të Kufizuara në Shqipëri

Të dhëna statistikore

Të dhënat dhe njohuritë statistikore për pozitën e personave me aftësi të kufizuara janë të pakta. Aktualisht ato reduktohen në numrin e personave me aftësi të kufizuara, llojet kryesore të aftësive të kufizuara, të cilat vlerësohen dhe përcaktohen nga komisione të veçanta specialistësh, pagesat në para që jepen nga buxheti i shtetit, si dhe disa shërbime mbështetëse që ofrohen në qendra rezidenciale dhe në komunitet. Aktualisht nuk ka të dhëna mbi strukturën gjinore të personave me aftësi të kufizuara, për aftësitë e kufizuara pas moshës së pensionit, të dhëna lidhur me situatën e punësimit të personave me aftësi të kufizuara, Niveli i punësimit të PAK është tepër i ulët. Vetëm 2275 nga 9533 persona me aftësi të kufizuara të aftë për punë kanë patur mundësinë e punësimit.

Numri i personave me aftësi të kufizuara sipas kategorive:

Lloji i PAK	Gjithsej	Qytet	Fshat	Kujdestarë
I. PAK të lindur ose të bërë të tillë deri në moshën 21 vjeç	44794	19669	25125	7288
a)mendorë, sensorë, fizikë	35.547	15 166	20381	3 593
b)Të verbër		4 197	4424	3 142
c)Para e tetraplegjikë	626	306	320	553
II Invalidët.	30 250	26 274	3976	1462²
a) Të punës	29 676	25 904	3.772	1500
b) Të luftës	574	370	204	
Gjithsej	75 044	45 943	29 101	8788

Aktualisht evidentohen 75,044 persona me aftësi të kufizuara¹. Këtu përfshihen vetëm ata persona me aftësi të kufizuara që janë komisionuar dhe përbëjnë objekt përfitimi. Në fakt numri i personave me aftësi të kufizuara është më i lartë. Kështu në grupin e parë, përfshihen 44,794 persona që janë bërë të paaftë para moshës 21 vjeç dhe ky kufizim i aftësive nuk iu ka ardhur nga puna, sepse, sipas legjislacionit në fuqi, nuk trajtohen personat që janë bërë të tillë pas moshës 21 vjeç.

Sipas shkakut të humbjes së aftësisë për punë:

- 3289 persona me aftësi të kufizuara janë të *aksidentuar në punë* apo me *sëmundje profesionale*, prej te cilëve 26,2% kanë humbur *plotësisht* aftësinë për punë, ndërsa 73,8 % kanë humbur *pjesërisht* aftësinë për punë.
- 26.378 kanë pësuar një aftësi të kufizuar për shkak të një *sëmundjeje të përgjithshme*.

Sipas shkallës së humbjes së aftësisë për punë invalidët e punës ndahen:

- 888 invalidë janë të paaftë dhe kanë nevojë për kujdestari,
- 14.527 invalidë janë të paaftë për punë,
- 9.533 invalidë kanë humbur pjesërisht aftësinë për punë,

¹ Të dhënat janë marrë nga statistikat e 6-mujorit të parë të vitit 2003

² 1462 invalidë që kanë nevojë për përkujdesje, përfitojnë një pagesë 15% të bazës së vlerësuar më shumë

- 4728 invalidë të punës kanë plotësuar moshën për pension pleqërie, por në bazë të ligjit nr.7703, dt.11.05 1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, neni 62, kanë përzgjedhur pensionin e invaliditetit, i cili i favorizon për përfitimet, që rrjedhin nga Statusi i Invalidit të Punës.

Krahas pensionit të invaliditetit dhe të të drejtave të përfitimeve nga Statusi i Invalidit, invalidët e punës përfitojnë edhe nga statuse të tjera. Kështu:

- 30250 invalidë përfitojnë shtese mbi pension nga Statusi i Invalidit (VKM Nr.204, dt 16.4.2004 “Për masën dhe kriteret për përfitimin e paaftësisë nga personat me statusin e invalidëve të punës” nga ose 9812 ose 33,1% e numrit të tyre të përgjithshëm, që përfitonin nga VKM nr.381, dt. 20 05.1996)
- 1935 invalidë përfitojnë nga statusi i te verbërit.
- 258 invalidë përfitojnë nga Statusi i paraplegjikut
- 328 invalidë janë të pajisur me mjete lëvizëse dhe përfitojnë rimbursim karburantesh.

Lidhur me numrin e invalidëve vërehen dy dukuri:

Gjatë 10 vjetëve të fundit rezulton se janë rritur pensionet e invaliditetit në qytet dhe më pak në fshat. Rritja e pensioneve të invaliditetit në qytet në raport me ato të fashitit, shpjegohet me përfshirjen në skemën e sigurimit të popullsisë rurale të aftë për punë. Periudha për të cilën ata paguajnë kontribute si bujq privatë njihet periudhë sigurimi në marrëdhënie pune me shtetin, e për rrjedhojë, pensioni i invaliditetit jepet nga puna në sektorin shtetëror.

Rekomandime

- Duhet të merren masa konkrete për mbledhjen e të dhënave të besueshme lidhur me numrin dhe tipologjitë e aftësisë së kufizuara në Shqipëri
- Këto të dhëna duhet të jenë të ndara sipas gjinive.

Vlerësimi i aftësisë së kufizuar

Aftësia e kufizuar në Shqipëri vlerësohet nga komisione të veçanta të specializuara, në përbërje të të cilëve ka specialistë të disiplinave të ndryshme, si: mjekë pediatër, okulistë, psikiatër etj.

Komisionet që vlerësojnë PAK janë: Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë, (KMCAP), Komisioni Mjekësor për Përcaktimin e Verbërisë (KMPV). Këto komisione janë në varësinë e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale (ISSH dhe SHSSH) dhe veprojnë në bazë të marrëveshjeve dhe rregulloreve të miratuara në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë.

Komisioni i Caktimit të Aftësisë për Punë është në varësi të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe realizon komisionimin e grupeve të personave me aftësi të kufizuara të ndarë sipas grupeve:

Grupi 1 janë personat me aftësi të kufizuara të lindur ose që janë bërë të tillë deri në moshën 21 vjeç;

Grupi 2 përfshin personat e aksidentuar, të sëmurur me sëmundje profesionale dhe të përgjithshme të bërë gjatë punës, kur kanë qenë të siguruar.

Një grup tjetër janë Invalidët e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare .

KMCAP vlerëson invalidët e punës me invaliditet të plotë, kur nga aksidenti ose shkaqe që lidhen me punën, kanë humbur me shumë se 67 % të aftësisë për punë dhe të pjesshëm, kur kjo humbje është 33%-65%.

Kur personat me aftësi të kufizuara të të dy grupeve, sipas vlerësimit të Komisionit, nuk janë në gjendje të kujdesen për veten, ata kanë të drejtë të zgjedhin një kujdestar, i cili paguhet për shërbimet ndaj

personit.invalidët e paaftë për punë që kanë nevojë për kujdestar, përfitojnë vetëm shtesë mbi pension në masën 15% dhe nuk kanë të drejtë të zgjedhin kujdestar apo t'u paguhet kujdestar.

Komisioni i Caktimit të Aftësisë për Punë ka degët e tij në 26 rrethe te vendit, të cilet janë të lëvizshëm, për të plotësuar nevojat për vlerësimin e grupeve me aftësi të kufizuara ne nivel lokal. KMCAP epror është i vendosur ne Tiranë dhe shqyrton te gjitha ankesat e qytetareve për KMCAP lokale.

Personat me aftësi të kufizuara ne shikim (të verbrit) vlerësohen nga një komision i veçantë, Komisioni i Caktimit te Verbërise, i cili vepron vetëm në Tiranë. Personat e verbër përfitojnë pension sipas kontributit të derdhur gjatë viteve të punës, një pagesë të veçantë per shkak te verbërise dhe mbështetjen me kujdestar, kur e kanë te nevojshem, si dhe lehtësi te tjera ne strehim, telekomunikacion etj.

Sipas llojit te aftësisë së kufizuar PAK grupohen në:

- sensorë, ku hyjne personat me aftësi të kufizuara dëgjimore dhe pamore;
- fizikë, ku hyjnë njerëzit me aftësi të kufizuara lëvizese si: para e tetraplegjiket, etj.
- mendorë, persona me çrregullime mendore ose sëmundje mendore kronike.

Ndonëse baza ligjore, statutet e veçanta etj. kanë krijuar mundësinë për të ofruar mbështetje në para apo shërbime, numri i PAK që përfitojnë trajtime mund të jetë më i lartë se sa ata që mbështeten nga programet sociale.

- ka përcaktime jo të plota për aftësinë e kufizuar,
- ka ende qëndrime dhe mentalitete nga ana e familjarëve për të mos i deklaruar PAK,
- ka mungesa në legjislacion dhe mos njohje të tij nga PAK ose familjarët e tyre, sidomos në zonat rurale dhe veçanërisht në zonat e thella,
- ka mjaft PAK që bëhen të tillë gjatë punës të pasiguruar, (puna e zezë)
- pensionistët nuk evidentohen në tërësinë e tyre nga komisionet.

Rekomandime

- Në bazë të parimit të përfshirjes, pjesëmarrjes dhe mundësive të barabarta dhe të vetëvendosjes kërkohet që mjediset e KMCAP duhet të sigurojnë hyrjen e lirë dhe pa pengesa për personat me aftësi të kufizuara.
- Të sigurohet në përbërjen e KMCAP-së pjesëmarrja e një përfaqësuesi të shoqatave të PAK, si edhe e drejta e ankimimit.
- Personat e vlerësuar duhet të kenë të drejtën të njihen me dokumentacionin e vlerësimit të tyre. Ata kanë të drejtë të marrin fotokopjet e vlerësimit të tyre. Komisionet duhet t'u japin të gjithë informacionin e nevojshëm personave me AK, sipas natyrës së aftësisë së tyre të kufizuar (p.sh. të verbrit duhet të kenë mundësinë ta marrin dokumentacionin në shkrimin brail.)
- Duhet të merren masa për sensibilizimin e personave të vlerësuar lidhur me legjislacionin në fuqi dhe të drejtat e tyre.
- Vlerësimi i rregullt vjetor i aftësisë së kufizuar nuk duhet të përqendrohet më tepër se ç'është e nevojshme në aftësinë e kufizuar në vetvete dhe në aspektin mjekësor të saj, duke lënë mënjanë masat e nevojshme për pjesëmarrjen e tyre në shoqëri.

Kuadri ligjor i Personave me Aftësi të Kufizuara në Shqipëri

▪ Shërbimet integruese dhe rehabilituese

Kuadri ligjor për përmirësimin e statusit shoqëror dhe ekonomik, i cili ka për qëllim të ofrojë garantimin e mundësive të barabarta për personat me aftësi të kufizuara në shoqërinë shqiptare, është duke u përmirësuar gradualisht. Kjo vjen si rezultat i ndikimit të vetë personave me aftësi të kufizuara, presionit të ushtruar nga grupet e komunitetet dhe organizatat që mbrojnë dhe përfaqësojnë të drejtat dhe interesat e tyre. Përmirësimi vjen gjithashtu si rezultat i rritjes së nivelit ekonomik të vendit dhe ndërgjegjësimit publik; ajo reflekton vullnetin e qeverisë shqiptare për të mbështetur personat me aftësi të kufizuara në mënyrë që t'i përfshijë ato në komunitetin ku ato jetojnë.

Mbështetja ekonomike e personat me aftësi të kufizuara ka ardhur duke u rritur. Në vitin 2003 buxheti për pagesën direkte për ta dhe për shërbimet në qendrat rezidenciale ka qenë 4.2 miliardë lekë, kurse për vitin 2004 buxheti për personat me aftësi të kufizuara kapi shifrën 4.7 miliardë lekë. Megjithatë, deri tani shërbimet që kanë pasur për qëllim rehabilitimin e personave me aftësi të kufizuara kanë qenë të pamjftueshme dhe me karakter afatshkurtër. Pavarësisht nga arsyet ekonomike, fondet shtetërore që mbulonin Aftësinë e Kufizuar kanë qenë modeste. OJQ-të janë përpjekur të ofrojnë disa shërbime rehabilituese, si dhe tipologji të reja shërbimesh. Me gjithë përpjekjet e bëra, shërbimet e ofruara janë të shkëputura dhe jo të integruara.

Qeveria e Shqipërisë mbështet organizatat në shërbim të personave me aftësi të kufizuara dhe i konsideron ato palë në hartimin dhe miratimin e akteve ligjore, politikave dhe programeve rreth këtij grupi.

Për më tepër Qeveria e Shqipërisë njeh domosdoshmërinë e reformave institucionale në funksion të zhvillimit të një sistemi përfshirës për Aftësinë e Kufizuar në mënyrë që legjislacioni në fuqi të marrë parasysh të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Kualifikimi dhe sensibilizimi i burimeve njerëzore përgjegjëse në qeveri është gjithashtu një çështje mbi të cilën autoritetet do të përqendrojnë vëmendjen dhe do të zhvillojnë projekte konkrete.

Legjislacioni i Republikës së Shqipërisë njeh të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Kështu **Kushtetuta e Shqipërisë** në nenin 25 garanton të drejtat dhe liritë themelore të personave me aftësi të kufizuara; në kreun V të Kushtetutës, ku parashtrihen Objektivat Sociale, në nenin 59, pika e) dhe pika f) nenvizohet "*Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe përgjegjësive private, synon...e) perkujdesjen dhe ndihmën për të moshuarit, jetimët dhe invalidët; f) riaftësimin shëndetësor, edukimin e specializuar dhe integrimin në shoqëri të të paaftëve, si dhe përmirësimin në vazhdimësi të kushteve të tyre të jetesës.*"; neni 52, pika 1 nënvizon: "*Kushdo ka të drejtën e sigurimeve shoqërore në pleqëri ose kur është i paaftë për punë, sipas nje sistemi të caktuar me ligj*", pika 2

Personi që mbetet pa punë për shkak të pavarura nga vullneti i tij dhe kur nuk ka mjete të tjera jetese, ka të drejtën e ndihmës në kushtet e parashikuara me ligj". Kurse Neni 49 mbi punësimin e barabartë parashikon: "*Çdo njeri ka të drejtë të sigurojë jetesën nëpërmjet një punë të ligjshme që ai/ajo ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai/ajo është i/e lirë të zgjedhë profesionin, pozicionin e punës dhe gjithashtu sistemin e kualifikimit për profesionin. Të punësuarit kanë të drejtën e mbrojtjes shoqërore*". Punësimi i personave me aftësi të kufizuara, sipas mundësive të tyre, parashikohet në statutet e grupeve të personave me aftësi të kufizuara, siç janë invalidët e punës, të verbërit, personat para dhe tetra-plegjikë dhe aktet nënligjore që zbatohen për ta.

Sistemi i Sigurimeve Shoqërore

Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 “Mbi sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” trajton me pensione invaliditeti personat që janë bërë të paaftë plotësisht ose pjesërisht, gjatë periudhës së sigurimit, për shkak të një aksidenti në punë, sëmundjeve profesionale ose të përgjithshme.

Invaliditet i plotë perfiton çdo muaj :

a.Nga nje semundje e pergjithshme,

-masa e pensionit	7266 lekë
-5% te pensionit baze per cdo femije ne ngarkim, por jo me shume se 20% sipas ligjit Nr.7703 dt. 11.05.1993 (neni 39)	1120 lekë
-kompesim per nje person ne ngarkim	414 lekë
-kompesim per energjine elektrike	350 lekë
per ndryshimin e cmimit te bukes	150 lekë
-shtesë paaftësie sipas VKM 204, dt.16.4.2004	3000 lekë
Gjithsej	<u>12 300</u> lekë

b.Nga nje semundje profesionale apo aksident,

12300 lekë

c.Per invaliditetin e plote nga nje semundje e pergjithshme qe ka nevojë per perkujdesje invalidi perfiton .

-masa e pensionit	7266 lekë
-shtese per perkujdesje	1600 lekë
-kompesim per femijet ne ngarkim	1120 lekë
-kompesim per nje person ne ngarkim sipas VKM 310, dt 24.04.1992	414 lekë
-kompesim per energjine	350 lekë
-kompesim per cmimin e bukes	150 lekë
-shtese sipas VKM 204	3000 lekë
Shuma	<u>13 900</u> lekë

**Per invaliditetin e pjesshem

a.Per invaliditetin e pjesshem nga semundje te pergjithshme (gr IV),

invalidi perfiton sipas neni 37 keto te ardhura :

-masa e pensionit	3633 lekë
-kompesimi i energjise	350 lekë
-kompesimi i cmimit te bukes	150 lekë
-nje person ne ngarkim	414 lekë
Shuma	<u>4547</u> lekë

b.Per invaliditetin e pjesshem si rezultat e

nje aksidenti e semundje profesionale ne pune,

invalidi perfiton edhe nje shtese

sipas VKM 204, dt 16.4.2004	2000 lekë
Shuma	<u>6547</u> lekë

▪ Invalidët e punës

Ligji nr. 7889, datë 14.12.1994 “Mbi Statutin e Invalidëve të Punës”, i ndryshuar më ligjin nr. 8052, datë 21.12.1995 “Mbi disa ndryshime të ligjit No. 7889”, datë 14.12.1994 dhe Ligjin Nr. 7821, datë 26.12.2000, ligji nr. 9143, dt.16.10.2003 “Për disa ndryshime në ligjin nr.7889, dt.14.12.1994”.

Statuti i invalidit parashikon shërbimet e mëposhtme:

100% rimbursim të trajtimit mjekësor për invalidët e plotë dhe 50% për ato që kanë humbur pjesërisht aftësinë për punë. Dispozita mbi mjetet lëvizëse parashikon përjashtimin e invalidëve nga taksat direkte dhe ato doganore për pajisje të ndryshme rehabilituese, duke përfshirë automjetet, shërbimi publik është falas, ndërsa transporti privat është 50% të vlerës.

Ligji parashikon kompensim të faturës së dritave dhe për koston minimale për ushqim, për personat me statusin e invaliditetit të cilët kanë qënë të punësuar më parë. Pensioni i invaliditetit ka një pagesë shtesë, prej 2000 ose 3000 lekësh për kategorinë e invaliditetit të pjesshëm ose të dhe paguhet një rimbursim prej 4000 lekësh për karburantin.

Pension invaliditeti në fshat

Në rast se invalidi jeton në fshat, masa e pensionit është 2980 lekë + kompensim shtesë në shumën prej 200 lekë = Total: **3180** lekë

Deleted: n

Ky nivel përfitimi mbetet i njëjtë edhe kur personi me aftësi të kufizuara ndryshon vendbanimin.

Deleted: n

▪ Veteranët e Luftës

Ligji Nr. 7663 dt. 21.01.1993 “Për statusin e invalidëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë” trajton me përfitime veteranët e luftës sipas grupeve të invaliditetit në varësi të pasojave të plagosjes apo gjymtimit. Ata marrin shtesë pagese përveç pensionit të invaliditetit ose mesatares së pensionit të invaliditetit në rast se nuk kanë pension, që gjen zbatim sipas grupit të invaliditetit.

Invalidët e grupit të parë gëzojnë të drejtën për një përkujdesës që paguhet nga strukturat e qeverisjes vendore. Përveç kësaj, ata marrin barna dhe trajtim mjekësor falas. Kur është e nevojshme, invalidët e luftës trajtohen në klinika jashtë vendit. Atyre u ofrohet transport urban falas dhe transport interurban me gjysëm çmimi.

▪ Të verbrit

Ligji 8098, datë 28.03.1996 "Për statusin e të verbërit" rregullon vlerësimin e aftësisë për të parë, integrimin në jetën normale dhe parashtron kushte normale për jetesë dhe punë si dhe kushte favorizuese për trajtim mjekësor.

Përveç ligjit kanë dalë edhe mjaft akte nënligjore në zbatim të tij, si VKM Nr. 227, datë 18.06.1997 “Për marrjen e statusit të të verbrit” për vlerësimin e aftësisë për të parë, VKM Nr. 671, datë 15.12.2000 “Për ngritjen e komisionit mjekësor të të verbërve” pranë SHSSH, VKM Nr. 83, datë 26.02.2001 “Për tarifën telefonike”, për energjinë elektrike, VKM Nr. 632, datë 21.11.2001 “Për përfitimet nga enti kombëtar i banesave” japin trajtim të veçantë lidhur me strehimin, Udhëzime të Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale për trajtimin ekonomik dhe shërbimet.

Pagesa minimale për të verbrit është 6400 lekë. Aktualisht ka 8715 të verbër që marrin shërbimet e sipërpërmendura. Ata klasifikohen sipas shkallës së përfitimeve që marrin:

- 8235 të verbër përfitojnë 100% të pagesës për aftësi të kufizuar (6800 lekë)
- 408 të verbër përfitojnë 150% të pagesës për aftësi të kufizuar
- 45 të verbër përfitojnë 200% të pagesës për aftësi të kufizuar
- 27 të verbër përfitojnë 300% të pagesës për aftësi të kufizuar, kur vazhdojnë shkollat e larta.

Aktualisht, 3451 të verbër marrin kujdestar që paguhet me 6800 lekë në muaj.

Të verbrit marrin shërbimet e mëposhtme, që nuk varen nga të ardhurat familjare: transport urban falas, 50% ulje të transportit privat bashkë me kujdestarinë, tarifa telefonike të nivelit të parë dhe 700 impulse pa TVSh dhe duhet të paguajnë vetëm 20% të faturës mujore telefonike. Të verbrit përjashtohen nga taksat doganore për makinat e tyre dhe kur janë të vetë-punësuar, paguajnë vetëm gjysmën e taksave. Ata paguajnë vetëm 20% të faturës së energjisë elektrike në muaj. Grupi i parë përfiton falas 1 dhomë. Përshtatjet e mjedisit bëhen me fonde nga shteti.

Shteti po financon për ngritjen e një qendre për rehabilitimin e të verbërve. Në vitin 2003 dhe 2004 janë akorduar nga 10 milion lekë për investim

▪ **Personat para- dhe tetraplegjikë**

Ligji Nr. 8626, dt 22.06.2000 “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik” dhe në zbatim të tij VKM Nr. 31, datë 20.01.2001 “Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, VKM Nr. 83, datë 26.02.2001 “Për tarifën telefonike dhe energjisë elektrike”, VKM Nr. 387 “Për përjashtimin e invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë nga taksat dhe tarifën” dhe VKM Nr. 687, datë 15.12.2000 rregullojnë të gjitha përfitimet dhe shërbimet për personat me aftësi të kufizuara para-dhe tetraplegjike.

Nga Ligji Nr 8026 përfitojnë vetëm invalidët paraplegjikët dhe tetraplegjikët që vuajnë nga sëmundje të shpinës si pasojë e një aksidenti dhe rregullon vlerësimin e tyre nga komisionet mjeksore (KMCAP) si dhe trajtimin. Paraplegjikët dhe tetraplegjikët që përfitojnë nga ky status janë invalidë të punës dhe si të tillë gëzojnë edhe të drejtat si invalidët e punës. Për rrjedhojë, këta persona marrin një pagesë shtesë prej 11450 lekë në muaj. Pagesa totale mujore është 18250 lekë. Për kujdesësit marrin 6800 lekë në muaj. Përfitojnë: mjekimet falas dhe shërbime në banesë, udhëtim me mjete shtetërore falas, me mjete private 50% së bashku me kujdestarinë.

Për trajtimin e paraplegjikëve dhe tetraplegjikëve është parashikuar të sigurohen dhoma të veçanta, si dhe barna falas e shërbim në shtëpi. Tarifa favorizuese për telefonin dhe energjinë elektrike janë të krahasueshme me ato të të verbërve. Dispozita të mëtejshme rregullojnë përjashtimin e këtyre personave me aftësi të kufizuara nga 11 lloj taksash dhe nga taksat doganore për importimin e pajisjeve për përdorim vetjak. Gjithashtu, ata marrin rimbursim të kostove për blerjen e karburantit ose vajit lubrifikant dhe përfitojnë nga pagesa për aftësinë e kufizuar.

▪ **Legjislacioni i ndihmës ekonomike dhe i shërbimeve të përkujdesit shoqëror**

Pagesa e aftësisë së kufizuar dhe ndihma ekonomike që u jepet personave me aftësi të kufizuara fizike, mendore dhe sensore, të lindur ose që janë bërë të tillë nga aksidente deri në moshën 21 vjeç, të verbrit, invalidët e punës para- dhe tetraplegjikë rregullohet nga **Ligji nr. 7710, dt. 18.05.1993** "Për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore", dhe një sërë aktesh nënligjore, siç janë: VKM Nr 307, datë 24.05.1994 “Për shërbimin e përkujdesit shoqëror”, VKM Nr. 311, datë 11.07.1994 VKM nr. 311, 11.7.1994 “Për përfitimin e paaftësisë” me disa ndryshime në VKM 457, 21.8.1995 dhe VKM 304, 27.6.2002 dhe Udhëzimet e Ministrisë të MPCS, VKM Nr.510, dt 24.11.1997 ”Per kriteret e vendosjes ne institucionet e perkujdesit”, VKM nr 786, 26.11.2003 “Për Komisionimin dhe pagesën për PAK”

Ky ligj dhe aktet nënligjore parashikojnë dhënien e ndihmës ekonomike, ku përfshihet edhe kjo kategori, dhe pagesës së paaftësisë, ofrimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror në institucionet rezidenciale publike dhe në ato të ngritura nga OJF-të për personat me aftësi të kufizuara, vlerësimin, rregullat e pagesës dhe shtesën përgjatë viteve. Janë hartuar dispozita për trajtimin në institucionet përkujdesëse, si publike ashtu edhe private dhe për pagesën e nxënësve dhe studentëve me aftësi të kufizuara. Nxënësit e shkollave të mesme marrin 200% të pagesës minimale, studentët marrin 300%. Kujdestari merrr 5000 lekë në rast se familja nuk ka të ardhura.

Në vend ekzistojnë 7 institucione rezidenciale publike, ku trajtohen rreth 1000 persona. Kostoja mesatare mujore për një person është 26000 lekë e siguruar nga fondet e buxhetit të shtetit. Veç këtyre institucioneve janë ngritur edhe nga OJF-të .

- **Sistemi i sigurimeve shëndetësore**

Ligji nr. 7880, dt. 13.10.1994 "Për sigurimin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë" mbron personat që kanë kontribuar në skemën e sigurimit shëndetësor përpara pësimit të aftësisë së kufizuar.

- **Shëndeti mendor**

Ligji nr. 8092, dt. 21.03.1996 "Për shëndetin mendor", mbron personat me aftësi të kufizuar mendore.

- **Legjislacioni i Punësimit**

Kodi i punës ndalon çdo lloj diskriminimi në punësimin dhe trajnimin profesional të njerëzve me aftësi të kufizuara. Ata kanë të drejtën të punojnë në punë të përshtatshme sipas vlerësimit të Komisionit Mjekësor të Vlerësimit që përcakton aftësinë e tyre për punë. Sipas Kodit të Punës, punëdhënësi duhet të ofrojë punë të përshtatshme dhe lehtësi për personat me aftësi të kufizuara. Orët e punës për personat me aftësi të kufizuara reduktohen në 6 orë në ditë.

Ligji nr. 7995, dt.20.09.1995 "Per nxitjen e punësimit", siguron dhe mbështet punësimin, këshillimin dhe kualifikimin profesional për personat me aftësi të kufizuara. Neni 15 parashikon që subjektet që kanë të punësuar 25 punonjës, një prej tyre duhet të jetë me aftësi të kufizuar në gjendje të punojë.

Punëdhënësi mund të zgjedhë të punësojë një person me gjendje të rënduar në vend të pesë personave me aftësi pjesërisht të kufizuara. Çdo punëdhënësi, i cili nuk përmbush këto kuota punësimi për personat me aftësi të kufizuara, do t' i paguajë Fondit Kombëtar të Punësimit një shumë të barabartë me pagën minimale për çdo person me aftësi të kufizuara që duhet të kishte punësuar. Neni 16 parashikon elementë nxitës për punëdhënësit e personave me aftësi të kufizuara: "Punëdhënësi i personave me aftësi të kufizuara mund të kërkojë subvencione nga Zyra e Punës për pajisje të përshtatshme për personin me aftësi të kufizuara. Pagesa për njerëzit me aftësi të kufizuar, përjashtohet nga tatimet siç përcaktohet nga Vendimet e Këshillit të Ministrave."

Neni 15 i këtij ligji, për arsye të ndryshme, nuk ka gjetur zbatim. Në vend mbizotërojnë bizneset e vogla me më pak se 25 punonjës, nuk ekzistojnë sanksionet dhe praktikatat për zbatimin e duhur të ligjit në fjalë dhe deri tani nuk janë gjetur ende mekanizma alternativë. Gjithashtu, për zbatimin e ligjit është i nevojshëm sensibilizimi i shoqërisë, autoriteteve tatimore dhe punëdhënësve.

Janë bërë përpjekje për krijimin e bizneseve të mbrojtura për punësimin e njerëzve me aftësi të kufizuara. Organizuar nga OJF-të dhe mbështetur financiarisht nga Shteti, janë marrë disa nisma për prodhimin e mjeteve të lëvizjes nga vetë njerëzit me aftësi të kufizuara. Ka disa nisma të suksesshme për punësimin e njerëzve me aftësi të kufizuar dhe grupe të tjera në nevojë; megjithatë duhet të sigurohet vazhdimësi në këtë drejtim dhe të promovohet punësimi për personat me aftësi të kufizuara.

Ligji nr. 8872, dt. 29. 03. 2002, "Për arsimim dhe formim profesional në Republikën e Shqipërisë", përfshin rregulla për trajnimin dhe formimin profesional, dhe personat me aftësi të kufizuara janë ndër përfituesit kryesorë të këtij ligji. Personave me aftësi të kufizuara ky ligj u siguron mundësinë e përgatitjes profesionale falas në qendrat publike dhe me pagesë në kurset private.

▪ **Arsimimi**

Ligji Nr. 7952 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, datë 21.06.1995, njeh të drejtën për arsim për të gjithë qytetarët, pavarësisht nga statusi i tyre social, kombësia, gjuha, gjinia, feja, raca, përkatësia politike, gjendja shëndetësore dhe niveli ekonomik.

Ky ligj parashikon hapjen e shkollave ose klasave të posaçme si dhe kualifikimin e personelit për të punuar me persona me aftësi të kufizuara. Në këtë linjë, në Vlorë u hap një degë e posaçme për kualifikimin e personelit arsimor të specializuar. Personat me aftësi të kufizuara mund të studiojnë në shkolla normale, në klasa të posaçme pranë shkollave normale, apo në shkolla të posaçme publike.

Institucionet speciale kombëtare përbushin 80% të nevojave për këtë lloj shkollimi dhe në rrethe 2% për shkollim ditor. Arsimimi i fëmijëve me nevoja të veçanta në institucionet arsimore publike është falas, nëse kjo është dëshira e prindërve dhe zgjedhja e duhur profesionale. Shteti ndërmerr masa për të garantuar kushtet e domosdoshme për integrimin gradual e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkolla normale. (Neni 40)

Aktualisht, 760 fëmijë ndjekin klasa të posaçme. Ekzistojnë dy institucione kryesore që mbulojnë nevojat e fëmijëve me humbje të shikimit dhe dëgjimit, që përbushin afërsisht 80-90% të kërkesës. Sa për institucionet e tjera të specializuara, ata mbulojnë më pak se 2% të kërkesave për trajtim.

Ministria e Arsimit, në bashkëpunim të ngushtë me institucione të tjera, ka bërë punë të lavdërueshme në sensibilizimin e shkollave për të pranuar fëmijë me aftësi të kufizuara në klasa normale. Sidoqoftë, shkollave u mungon infrastruktura bazë dhe vetë mësuesit nuk kanë trajnimin e duhur për të mbështetur këtë proces.

▪ **Transporti dhe jetesa pa barriera**

Ligji Nr. 8308 “Për transportin rrugor”, datë 18.03.1998 dhe Udhëzimi i Ministrisë Nr. 1649, datë 16.08.1999 sigurojnë lehtësi për njerëzit me aftësi të kufizuara në përdorimin e transportit. Ata gëzojnë të drejtën e përdorimit falas të transportit urban dhe çmime të reduktuara për transportin ndërurban.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.401, datë 25.6.2004 “Për një shtesë në VKM nr 722, datë 19.11.1998, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së urbanistikës” ndihmon për të hequr barrierat për personat me aftësi të kufizuara. “Rregullat dhe normat urbanistike për personat me aftësi të kufizuara” përpunuar nga Ministria e Rregullimit të Territorit dhe organizatat e shoqërisë civile (Grupi i punës i Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Aftësisë së Kufizuar, Instituti i Inxhinierisë, Shoqata Kombëtare e Ndërtuesve) është një arritje e cila i detyron me ligj që të gjitha aktivitetet ndërtuese të shmangin barrierat për njerëzit me aftësi të kufizuara.

Rekomandime

- Siç u përkrah në këtë kapitull, kuadri ligjor lidhur me personat me aftësi të kufizuara në Shqipëri është i shpërndarë. Lind nevoja e studimit të legjislacionit ekzistues dhe për të parë mundësinë e nxjerrjes së një ligji të unifikuar mbi statutet e veçanta të personave me aftësi të kufizuara në Republikën e Shqipërisë.
- Ky studim duhet të ndërmerret nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, si ministria kryesuese në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Drejtësisë dhe organizatat përkatëse të shoqërisë civile për çështje të personave me aftësi të kufizuara.

- Personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtën të informohen mbi të drejtat dhe privilegjet që gëzojnë. Qeveria dhe institucionet jo-qeveritare duhet të bashkohen për të koordinuar masat për ndërgjegjësimin e publikut dhe të botojnë vazhdimisht broshura informative, në të cilat të përmbledhen, në një gjuhë të kuptueshme, të gjitha të drejtat, pagesat, rimbursimet dhe shërbimet.
- Republika e Shqipërisë ka ratifikuar Kartën e Rishikuar Sociale Evropiane, por ka lënë mënjanë ratifikimin e Nenit 15. Rekomandohet që, në këtë kontekst, të jepet një shenjë e qartë ndaj Këshillit të Evropës se Qeveria e Republikës së Shqipërisë ka vullnetin për zbatimin e politikës së mosdiskriminimit dhe pjesëmarrjes.

Fushat e Ndërhyrjes / Plani i Veprimit²

Analiza e politikave aktuale në fushën e aftësisë së kufizuar në Shqipëri nxjerr në pah dy sfida kryesore:

- 1) Përmirësimin e politikave koherente, të cilat duhet të harmonizohen me standardet ndërkombëtare
- 2) Zbatimin e përpiktë të ligjeve dhe rregulloreve në fuqi.

Është e vetëkuptueshme se realizimi i përfshirjes së plotë të personave me aftësi të kufizuara në jetën sociale në Shqipëri ka nevojë për një proces afatgjatë dhe shumëdimensional, suksesi i të cilit varet në masë të madhe nga përpjekjet e administratës shqiptare dhe të shoqërisë civile në Shqipëri.

Qeveria e Republikës së Shqipërisë shpreh angazhimin e saj të plotë për të punuar në vazhdimësi përkundrejt dy sfidave kryesore të përmendura më lart, duke shprehur njëkohësisht gadishmërinë për të shfrytëzuar përvojën dhe kontributin e OJF-ve të këtij sektori.

Objektivi themelor i të gjithë këtyre politikave duhet të jetë *përmirësimi i konsiderueshëm i kushteve të jetesës së personave me aftësi të kufizuara* nëpërmjet arritjes së rezultateve afatgjata në përfshirjen e tyre në shoqëri si qytetarë që ushtrojnë të drejtën e vetëvendosjes, dhe që gëzojnë të drejtat e plota civile dhe njerëzore.

Për këto arsye, Qeveria e Shqipërisë dhe përfaqësuesit e personave me aftësi të kufizuara kanë vendosur të përqendrojnë përpjekjet e tyre në fushat primare të 1) përshtatshmërisë ndërtimore 2) shërbimeve për aftësinë e kufizuar 3) arsimimit, punësimit dhe trajnimit profesional 4) ngritjes së kapaciteveve 5) punës kërkimore dhe kuadrit ligjor. Qëllimet dhe parimet e strategjisë të përshkruara në kapitullin II do të zbatohen në të gjitha politikat dhe projektet, duke vënë në planë të parë të drejtën e vetëvendosjes së personave me aftësi të kufizuara.

Rritja e përfshirjes shoqërore të personave me aftësi të kufizuara do të zhvillohet paralelisht me procesin e ndërgjegjësimit të shoqërisë, gjë që do të rezultojë në përfshirjen e të gjithë shoqërisë në këtë proces.

Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet krijimit të një strukture efektive monitorimi dhe raportimi, e cila do t'u mundësojë të gjitha palëve të përfshira në proces, duke futur këtu edhe donatorët ndërkombëtarë, të matin progresin në zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara.

² Plani i veprimit i SKPAK, i cili përmban objektivat, masat, afatet e realizimit dhe institucionet përgjegjëse i bashkangjitet Strategjisë në Shtojcën I.

Fusha e veprimit 1. Jetesa pa barriera

Ndërtimi i një mjedisi pa barriera është padyshim një çështje kyçe për mundësitë e përfshirjes së njerëzve me aftësi të kufizuara në të gjithë sektorët e jetës sociale, duke përfshirë integrimin e tyre në të gjitha fushat e arsimit dhe punësimit.

Si Këshilli i Evropës, ashtu edhe Bashkimi Evropian vitet e fundit janë përqëndruar mbi këtë çështje dhe përpjekjet e tyre kanë çuar në një sërë zgjidhjesh, duke përfshirë përkufizimet, standardet dhe masat për jetesën pa pengesa dhe projektim universal. Kombet e Bashkuara e kanë parashtruar gjithashtu këtë parim në rregullat standarte të Kombeve të Bashkuara.

Ndërtesat dhe mjediset e tjera, mjetet e transportit, pajisjet teknike, sistemet e përpunimit të informacionit, burimet akustike dhe pamore të informacionit, lehtësitë e komunikimit dhe mjediset e tjera do të konsiderohen pa pengesa, nëse ato janë të arritshme dhe të shfrytëzueshme nga personat me aftësi të kufizuara në mënyrë të zakonshme, pa vështirësi të veçanta, si rregull, pa ndihmë e të tjerëve.

Jeta pa pengesa është pra një parakusht për gëzim të plotë dhe të barabartë të të drejtave civile dhe për shfrytëzim të lirë të të gjitha shërbimeve në mënyrë të barabartë me të gjithë shtetasit e tjerë. Qeveria shqiptare dhe të gjitha palët e interesuara do të mbajnë parasysh këtë gjë në hartimin e legjislacionit të ardhshëm dhe standarteve për përshtatshmërinë e mjedisit.

Për rrjedhojë, heqja e pengesave vizive dhe fizike në jetën e përditshme të njerëzve me aftësi të kufizuara do të jetë vetëm një pikënisje. Përpjekjet e para për heqjen e barrierave për njerëzit me aftësi të kufizuara, siç u tha më sipër, tashmë janë ndërmarrë. Miratimi në Këshillin e Ministrave të ndryshimeve në Rregulloren e Urbanistikës¹ është një hap i rëndësishëm.

Heqja e barrierave për personat me aftësi të kufizuara do të synojë:

1. Përfshirjen e tyre në jetën shoqërore, duke patur parasysh kushtet aktuale të infrastrukturës publike në Shqipëri, e cila përbën pengesën më të madhe për pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në jetën e përditshme, si dhe në pjesëmarrjen e tyre në arsimim, punësim dhe formim profesional.
2. Sjellja e personave me aftësi të kufizuara “në vëmendje” të shoqërisë të shihet si një faktor i rëndësishëm në procesin e rritjes së vetëdijësimit në shoqëri; ajo do të hedhë bazat për një ndjeshmëri më të madhe të ligjvënësve dhe të të mbarë shoqërisë.

Masat që do të merren¹:

- Ndërtimi i strukturave për të mundësuar njerëzit me aftësi të kufizuara të marrin pjesë në të gjithë sektorët e jetës sociale-ekonomike dhe kulturore. Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet pjesëmarrjes së tyre në jetën politike, veçanërisht në pjesëmarrjen në zgjedhjet e përgjithshme dhe ato vendore, meqë pjesëmarrja është një e drejtë e domosdoshme civile që e gëzojnë njerëzit me aftësi të kufizuara.
- Heqja e pengesave për informacionin, komunikimin dhe transportin si dhe vendosja e standardeve, duke mbajtur parasysh se e drejta për informim është një e drejtë legjitime publike e të gjithë shtetasve në Republikën e Shqipërisë. Për rrjedhojë, njerëzit me aftësi të kufizuara duhet të gëzojnë të drejtën të marrin informacionin për të gjitha shërbimet në Brail, shenja ose në gjuhë të kuptueshme për ta.
- Çështjet e aftësisë së kufizuara të futen si një element i detyrueshëm në programet mësimore, si në profesionet arkitekturë, projektim-ndërtim-teknologji, media, shkenca sociale etj.

¹ Realizimi i masave jepet i detajuar në Planin e Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara, ku institucionet përgjegjëse marrin detyrat, përgjegjësitë dhe afatet e tyre.

Fusha e veprimit 2. Shërbimet

Projekt-Ligji i ri “Për Ndhimën ekonomike dhe shërbimet shoqërore” që do të miratohet së shpejti në Kuvend, institucionalizon praktikat e përdorura në vendet e zhvilluar, në të cilët shërbimet sociale realizohen pranë komuniteteve dhe organizatat e shoqërisë civile ofrojnë një spektër të gjerë shërbimesh për personat me aftësi të kufizuara në nivel komuniteti. Pushteti vendor i kontraktton këto shërbime tek OJF-të e specializuara sektoriale dhe i kontrollojnë ato. Ky sistem hedh hapat e parë në Shqipëri, në sajë të angazhimit të administratës shtetërore, për shfryrjen e aparatit të nëpunësve buxhetorë me qëllim reduktimin e deficitit publik. Nga ana tjetër, ligji i ri për Ndhimën ekonomike dhe shërbimet shoqërore vë në pah vlerësimin e administratës shqiptare ndaj shërbimeve të ofruara nga organizatat e vetë personave me aftësi të kufizuara.

Sistemi i shërbimeve për aftësinë e kufizuar që po krijohet në Shqipëri është pasojë e zhvillimeve nëpër të cilat po kalon e gjithë shoqëria shqiptare. Sidoqoftë, do të vazhdojnë të mbeten përgjegjësi e Qeverisë politikat për ofrimin e të gjitha llojeve të shërbimeve shëndetësore. Për këtë arsye, autoritetet qendrore dhe vendore do të përcaktojnë prioritetet e veta për përmirësimin e sistemeve të parandalimit të hershëm të aftësisë së kufizuar, si dhe për përmirësimin e shërbimeve mjekësore dhe rehabilituese për personat me aftësi të kufizuara.

Në vendet e Europës Perëndimore zhvillimet e fundit të politikave për aftësinë e kufizuar priren drejt përcaktimit të buxheteve individuale për personat me aftësi të kufizuara, të cilat u mundësojnë këtyre të fundit zgjedhjen e shërbimeve më të përshtatshme për ta.

Qeveria shqiptare do të synojë të ndjekë këtë objektiv, i cili bazohet në realizimin e parimit të vetëvendosjes. Megjithatë, situata ekonomike e pjesës më të madhe të familjeve të personave me aftësi të kufizuara në Shqipëri bart me vete rrezikun e përdorimit të parave të këtyre buxheteve individuale për aftësinë e kufizuar jo në drejtim të blerjes së shërbimeve të nevojshme, por në drejtim të plotësimit të buxhetit bazë të familjes. Për këtë arsye, në kuadrin afatmesëm dhe afatshkurtër, prioriteti i qeverisë do të jetë dhënia e shërbimeve të kualifikuara duke patur gjithnjë parasysh nevojat e vetë personave me aftësi të kufizuara.

Qeveria Shqiptare dhe organizatat e personave me aftësi të kufizuara do t’i kushtojnë rëndësi të veçantë dhënies së shërbimeve të kujdestarisë në nivel komuniteti. Garantimi i nivelit të lartë të këtyre shërbimeve do të jetë një çështje e cila do të trajtohet me përgjegjësi. Personat me aftësi të kufizuara duhet të kenë të drejtën të vendosin lidhur me kujdestarinë e përshtatshme për ta, ndonëse në legjislacionin e sotëm theksohet se kujdestari zgjidhet prej tyre.

Rëndësi e veçantë do t’i jepet krijimit të qendrave ditore me baza komunitare dhe shërbimeve nëpër shtëpi, të cilat me kalimin e kohës do të jenë llojet më të përdorura të shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara.

Shërbimet sociale cilësore do të vendosen në fokus të përpjekjeve për zbatimin e kësaj strategjie. Në nivelin vendor do të synohet krijimi i qendrave të shërbimit social komunitar, të cilat do të realizojnë shërbime këshillimi, kujdestarie, rehabilitim dhe integrimi, ku personave me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre do t’u ofrohet këshillimi lidhur nevojat individuale dhe ndërdisiplinore të tyre dhe në të ardhmen personat me aftësi të kufizuara të trajtohen nëpërmjet planeve individuale të rehabilitimit dhe pjesëmarrjes.

Personeli i qendrave të ardhshme të ofrimit të shërbimeve social duhet të jetë i kualifikuar në fushën e shërbimeve sociale për personat me aftësi të kufizuara dhe me formim ndërdisiplinor. Koncepti i krijimit të një rrjeti kombëtar qendrash shërbimi social është në thelb të kësaj strategjie. Gjithashtu merret parasysh ideja e krijimit të njësive të lëvizshme, të cilat do të plotësojnë nevojat personave me

aftësi të kufizuara në zonat rurale. Ndërtesat e këtyre qendrave duhet të ndodhen në afërsi apo brenda ndërtesave të komunave. Duhet të ndërmerren masat e nevojshme që të garantohet përshtatshmëria ndërtimore e tyre.

Në bazë të filozofisë së dhënies së shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara është që shërbimet duhet të ndjekin individin dhe jo e kundërta. Aktualisht kjo filozofi e shërbimit përdoret nga disa shoqata të aftësisë së kufizuar me rezultate të mira. Inisiativa shtetërore nuk duhet t'i zëvendësojë këto lloj shërbimesh, por t'i plotësojë dhe t'i përmirësojë ato. Gjatë krijimit të qendrave të shërbimit, rëndësi e veçantë i duhet dhënë punësimit të personave me aftësi të kufizuara në këto qendra.

Fusha e veprimit 3. Punësimi, Formimi Profesional dhe Arsimimi

Papunësia tek njerëzit me aftësi të kufizuara në Shqipëri konsiderohet si një prej problemeve të tyre kryesore. Njerëzit me aftësi të kufizuara rrallëherë shohin mundësi të fitojnë vetë jetesën e tyre dhe të marrin pjesë plotësisht në shoqëri. Nevoja për integrimin e tyre pa kompromis të në sferën e punësimit është në përputhje të plotë me përparësitë e vendosura nga Bashkimi Evropian: Plani i Veprimit i Komisionit Evropian për promovimin e mundësive të barabarta dhe luftën kundër diskriminimit vendos një theks të veçantë mbi punësimin e njerëzve me aftësi të kufizuara në vitin 2003. Vendet e punës duhet të parashikohen pa pengesa dhe duhet të përshtaten në përputhje me nevojat e njerëzve me aftësi të kufizuara. Ata duhet të mbështeten edhe për ngritjen e biznesit të tyre.

Pavarësisht nga Ligji Nr. 7995 "Për nxitjen e punësimit" datë 20.09.1995, duhet të bëhen përpjekje më efektive për të integruara njerëzit me aftësi të kufizuara në tregun e punës.³ Edhe OJF-të duhet të luajnë një rol vendimtar për vetë-mbështetje dhe duhet të marrin mbështetje jo vetëm nga donatorët, por edhe nga vetë Qeveria Shqiptare. Kjo ka nisur tashmë nëpërmjet Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, që mbështet disa projekte punësimi të OJF-ve.

OJF-të shqiptare që punojnë me aftësinë e kufizuar kanë kontribuar deri tani në mënyrë të konsiderueshme me ekspertizën e tyre për të trajnuar njerëzit me aftësi të kufizuara dhe për të mbështetur integrimin e tyre në tregun e punës. Megjithatë, duhet mbajtur parasysh se ndërtimi i kapaciteteve në institucionet shtetërore duhet të ketë për synim mbështetjen e mundësive, që Agjencia Shtetërore e Punësimit të jetë më efektive në sjelljen e njerëzve me aftësi të kufizuara në forma të hapura ose alternative të punësimit. Madje, Shërbimi Kombëtar i Punësimit duhet të krijonte një bashkëpunim më të ngushtë me OJF-të që operojnë në fushën e aftësisë së kufizuar. Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale duhet të marrë masa konkrete për të siguruar zbatimin efektiv të Ligjit eksistues "Për nxitjen e punësimit."

Meqë vetë njerëzit me aftësi të kufizuara shpesh kanë mangësi në kualifikim dhe mjeshtëri, si pasojë e përjashtimit nga sistemi i arsimimit dhe i përgatitjes profesionale, është e rëndësishme të bëhet përpjekje më të madha në këtë sektor, duke u nisur nga kopshtet, duke vijuar me të gjitha nivelet e shkollimit, arsimin universitar dhe përgatitjen profesionale, duke mundësuar njerëzit me aftësi të kufizuara të ndërtojnë kapacitetin e tyre në mënyrë të barabartë.

OJF-të duhet të mbështeten më shumë nga Qeveria në përpjekjet e tyre për të ofruar trajnim profesional për njerëzit me aftësi të kufizuara, por vetë qeveria shqiptare është gjithashtu e vetëdijshme për detyrimin për të ofruar trajnim profesional për njerëzit me aftësi të kufizuara në programet e tyre të trajnimit.

Synimi është krijimi i një sistemi të integruar kopshtesh dhe shkollash të nivelit fillor dhe të mesëm. Ministria e Arsimit është duke punuar tashmë për një politikë në vijueshmëri mbi arsimimin integruar,

³ Ligji i përmendur është një përpjekje e lavdërueshme, që parashikon që nga 25 punonjës, 1 duhet të jetë person me aftësi të kufizuara në gjendje të punojë. Sidoqoftë, pas këtij ndryshimi në vitet '90^{te}, ndërmarrjet e mëdha pothuajse pushuan së ekzistuari dhe bizneset e vogla normalisht kanë më pak se 25 punonjës.

duke përmirësuar kurrikulat shkollore, duke ngritur klasat e integruara deri duke përfshirë mënjanimin e pengesave dhe ndërtimin e kapaciteteve njerëzore.

Heqja e pengesave fizike në shkolla, universitete dhe qendra të trajnimit profesional është një hap i rëndësishëm, por ai përbën thjesht një parakusht të domosdoshëm për zbatimin e konceptit të integritimit në procesin e përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në të gjitha nivelet e arsimit, studimit dhe trajnimit. Duke patur parasysh gjendjen e arsimit në Shqipëri, një sistem miks i shkollave të integruara dhe shkollave të posaçme, do të konsiderohej zgjidhja më e mirë afatshkurtër. Si qeveria shqiptare asstu edhe organizatat e shoqërisë civile duhet të bashkëpunojnë ngushtë për ndërtimin e një sistemi arsimor, ku shkollat e integruara do të përbëjnë normën e arsimit të PAK. Nevojat e veçanta të të gjithë kategorive të njerëzve me aftësi të kufizuara do të plotësohen në klasa të veçanta në këto shkolla vetëm kur konsiderohet e nevojshme. Jeta sociale në vetvete dhe të gjitha veprimtaritë kulturore do të duhet të zhvillohen mbi baza të integruara.

Për të ngritur nivelin e personelit që punon në fushën e aftësisë së kufizuar, një objektiv madhor duhet të jetë edhe hartimi dhe zbatimi i programeve për mësues të shkollave, mjekë, arkitektë, punonjës socialë, psikologë, etj., ku të përfshihen njohuri për Aftësinë e kufizuar.

Fusha e veprimit 4. Ngritja e Kapaciteteve

Ngritja e kapaciteteve në fushën e aftësisë së kufizuar është pika e mëtejshme kyçe e kësaj strategjie. Njohuritë e punonjësve të administratës shqiptare lidhur me legjislacionin në fuqi mbi aftësinë e kufizuar janë fragmentare. Nga ana tjetër, edhe në OJF-të e aftësisë së kufizuar ka mungesa njohurish mbi legjislacionin dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

Qeveria Shqiptare është e angazhuar të administrojë në mënyrë aktive çështjen e aftësisë së kufizuar në Shqipëri duke përditësuar gjithmonë e më shumë të drejtat e PAK në politikat e saj sektoriale.

Për arritjen e këtij qëllimi është i nevojshëm realizimi i një sërë trajnimesh dhe shkëmbim përvojash nga praktikantët e mira të punës të vendeve të tjera. Ekziston nevoja e konsultimit me ekspertë nga vendet me përvoja të përparuara në fushën e politikave të aftësisë së kufizuar.

Strategjia përcakton nevojën e trajnimit të kujdestarëve të personave me aftësi të kufizuara në mënyrë që të rritet cilësia e shërbimit ndaj tyre. Projektet e përfshira në planin afatshkurtër i veprimit të kësaj strategjie përfshijnë trajnime për avokatët, gjyqtarët dhe prokurorët lidhur me aspektet ligjore të aftësisë së kufizuar.

Fusha e veprimit 5. Kuadri ligjor dhe puna kërkimore

Në Shqipëri ekziston një kuadër ligjor lidhur me personat me aftësi të kufizuara, i cili rregullon komisionimin dhe legjislacionin mbi pagesat, të drejtat dhe shërbimet e tyre. Megjithatë, analiza e situatës aktuale ka treguar se legjislacioni ka natyrë fragmentare, gjë që kushtëzoi mungesën e njohurive të plota mbi të si në nivel shtetëror, ashtu edhe midis vetë personave me aftësi të kufizuara. Për këtë arsye, zhvillimi i një kuadri ligjor koherent lidhur me aftësitë e kufizuara është njëri nga prioritetet e kësaj strategjie.

Me qëllim harmonizimit të legjislacionit shqiptar me standardet ndërkombëtare bazuar në parimet e parashtruara në kapitullin 1, ekziston nevoja e një studimi të përgjithshëm të kuadrit ekzistues legjislativ, statistikor dhe institucional.

Për të njohur personat me aftësi të kufizuara me të drejtat e tyre, strukturat shtetërore, të përfshira në këtë strategji, në bashkëpunim me OJF-të e aftësisë së kufizuar të publikojnë herë pas here në broshura, të gjitha shërbimet, të drejtat ligjore dhe përfitimet e personave me aftësi të kufizuara.

Pavarësisht nga projektet e renditura në vijim sipas fushave të ndërhyrjes, Qeveria e Republikës së Shqipërisë angazhohet të japë shenja të qarta përkundrejt komunitetit ndërkombëtar, Këshillit të Europës dhe Bashkimit Europian duke pohuar qëllimin e saj për zbatimin e një politike të avancuar jodiskriminuese dhe gjithëpërfshirëse për aftësinë e kufizuar, në kuadër të së cilës ajo do të:

- Ratifikojë nenin 15 të Kartës së Rishikuar Sociale Europiane (RESC).
- Krijojë një kuadër të qëndrueshëm ligjor duke vendosur parimin e jodiskriminimit të PAK në përputhje me Kushtetutën shqiptare. Gjithashtu, në bashkëpunim me shoqërinë civile të studiohet legjislacioni ekzistues dhe të synohet hartimi i një ligji shqiptar mbi mundësitë e barabarta, sa më parë që të jetë e mundur.
- Bashkëpunojë në mënyrë aktive në procesin në zhvillim e sipër të hartimit të Konventës së Përgjithshme dhe Integrale të OKB mbimbrotjtjen dhe promovimin e të Drejtave dhe dinjitetit të personave me aftësi të kufizuara, duke përfshirë komunikimin me vendet anëtare të BE.
- Shkëmbejë në mënyrë të vazhduar përvojat me OJQ-të sektoriale të aftësisë së kufizuar, me anë të konsultimeve midis tyre, ministrisë së linjës dhe MPJ lidhur me zhvillimet e konventës së OKB.

Struktura e Monitorimit dhe Raportimit për Strategjinë Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara

1. Këshilli Kombëtar për Çështje të Aftësisë së Kufizuar

Anëtarët: Zëvendëskryeministri (Kryetar i Këshillit)
Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale, Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Ministri i Shëndetësisë, Ministri i Drejtësisë, Ministri i Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Ministri i Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit
4 OJQ Kombëtare të Aftësisë së Kufizuar

Shpeshhtësia e takimeve (sipas mandatit të Këshillit Kombëtar): të paktën 3 herë në vit

Detyrat: ÷ Politikëbërja e për Aftësinë e Kufizuar në nivel kombëtar, bazuar në Plan-Veprimin e Strategjisë Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara.
÷ Garantimi i përfshirjes së dimensionit të Aftësisë së Kufizuar në politikat e institucioneve të Republikës së Shqipërisë
÷ Rekomandime për hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore lidhur me Aftësinë e Kufizuar .
÷ Hartimi i raportit përmbledhës mbi gjendjen e Aftësisë së Kufizuar në Shqipëri⁴

Nevojat: Hartimi i statutit të Këshillit Kombëtar

2. Sekretariati Teknik

Anëtarët: 3 të punësuar me kohë të plotë pranë strukturave të MPCÇS (Shërbimit Social Shtetëror)

Autoriteti i

linjës: Drejtoria e Shërbimeve Sociale

Në varësi: Koordinatorët e ministrive

Nevojat: Kriteret përzgjedhjeje për 3 të punësuarit dhe përshkrime pune Statuti, Mandati, dhe Rregullorja e punës së sekretariatit teknik (e miratuar nëpërmjet VKM)⁵

Ngritje kapacitetesh:

- Në të gjitha aspektet e aftësisë së kufizuar me theks mbi shërbimet dhe zgjidhjet ligjore, përshtatshmërinë mjedisore, punësimin, arsimimin dhe kualifikimin profesional për AK
- Menaxhimin e projekteve
- Menaxhimin e zyrës dhe kontakteve
- Menaxhimin e teknologjisë së informacionit
- Anglishten

Detyrat: ÷ Mbledhja dhe Shpërndarja e Informacionit
÷ Mbajtja e marrëdhënieve me pikat e kontaktit nëpër ministrinë e linjës

⁴ Raporti i dorëzohet Kuvendit të Shqipërisë si organi më i lartë i përfaqësimit demokratik në vend. Raporti publikohet dhe u dërgohet të gjitha institucioneve qeverisëse dhe joqeveritare në Shqipëri, si edhe donatorëve ndërkombëtarë. Gjatë 3 viteve të para të zbatimit të strategjisë raporti jepet çdo vit. Më pas raporti jepet çdo dy vjet.

⁵ Sekretariati teknik ka të drejtën të marrë raporte të rregullta nga pikat e kontaktit nëpër ministri, zyrat rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe nga qeveria lokale. Me kërkesën e Sekretariatit Teknik, informacioni u jepet të gjitha institucioneve të lartpërmendura, INSTAT dhe organizatave të shoqërisë civile.

- ⌘ Mbajtja e marrëdhënieve me OJF-të e AK të përfaqësuara në Këshillin Kombëtar dhe Këshillin Administrativ
- ⌘ Mbajtja e marrëdhënieve me 12 zyrat rajonale të SSSH
- ⌘ Përgatitja e takimeve të Këshillit Kombëtar dhe Këshillit Administrativ
- ⌘ Raportimi për Këshillin Administrativ⁶

3. Këshilli Administrativ i Shërbimit Social Shtetëror

- Anëtarët:** Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale (kryetar), Drejtori i Shërbimit Social Shtetëror (zëvendëskryetar) Drejtori i ISSH, Drejtori i SHKP, Zëvendësministri i Ministrisë së Qeverisjes Vendore dhe Decentralizimit, Zëvendësministri i Ministrisë së Shëndetësisë, Zëvendësministri i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, përfaqësuesi i Drejtorisë së Buxhetit në Ministrinë e Financës, dhe përfaqësues nga shoqatat e Aftësisë së Kufizuar, i cili do të zgjidhet me votim nga rrjeti i shoqatave të Aftësisë së Kufizuar.
- Në varësi:** Sekretariati teknik, pikat e kontaktit nëpër ministri
- Detyrat:** ⌘ Mbikqyr zbatimin e Strategjisë Kombëtare
 ⌘ I jep rekomandime Këshillit Kombëtar
 ⌘ Jep direktivat e punës dhe përgjigjet për mbikqyrjen e punës së sekretariatit teknik
 ⌘ Jep direktivat e punës për 12 zyrat rajonale të SSSH
 ⌘ Jep direktivat e punës për njësitë e pushtetit vendor
- Nevojat:** Rregullore pune, rutina e mbledhjeve⁸, procedurat e votimit⁹, organizimi i përzgjedhjes së 3 OJQ-ve që përfaqësohen në Këshillin Kombëtar¹⁰, procedurat dhe praktikatat e raportimit në Këshillin Kombëtar

4. Pikat e Kontaktit në Ministrinë e Linjës

- Anëtarët:** Një person i përzgjedhur si pikë kontakti nëpër ministrinë e mëposhtme: MASH, MSH, MD, MRRTT, MPVD, MTT
- Autoriteti i linjës** Sekretariati teknik
- Në varësi:** Sipas VKM të gjithë departamentet e ministrive përkatëse
- Nevojat:** Kriteret për përzgjedhjen, hartimi i përshkrimit të punës
 Ngritje kapacitetesh:
- Në fushën e aftësisë së kufizuar që prek punën në ministrinë përkatëse
 - Menaxhimin e projekteve
 - Menaxhimin e zyrës
 - Menaxhimin e teknologjisë së informacionit

⁶ Raportimi realizohet në mënyrë të rregullt çdo dy muaj të paktën 10 ditë përpara mbledhjes së Këshillit Administrativ.

⁸ Gjatë dy viteve të para të zbatimit të Strategjisë, Këshilli Administrativ mblidhet 6 herë në vit. Pas dy vitesh, Këshilli ka të drejtë të rishikojë rutinën e mbledhjeve. Këshilli Administrativ duhet të mblidhet 3 javë përpara mbledhjes së Këshillit Kombëtar.

⁹ Institucionet qeveritare dhe ato joqeveritare të përfaqësuara në Këshill kanë të drejtë vote. Çdo institucion ka të drejtën e një vote

¹⁰ OJQ-të rajonale duhet të jenë OJQ që punojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, të merren me aftësinë e kufizuar në mënyrë ndërsektoriale dhe të kenë një përvojë pune jo më pak se 5-vjeçare në fushën e aftësisë së kufizuar.

Detyrat: Informon sekretariatit teknik
 Informon zëvendësministrin përkatës në Këshillin Administrativ të SSSH
 Mban kontakte me njësitë e pushtetit lokal nën vartësi të ministrisë
 Mban kontakte pune me OJQ-të e përfaqësuar në Këshillin Administrativ

5. Zyrtat Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror

Anëtarët: Staf i zyrtarëve rajonale, 1 person nga qendrat e shërbimit social (sipas projektit të SHSSH)

Autoriteti i linjës: Sekretariati Teknik, Këshilli Administrativ i SHSSH

Nevojat : Kriteret e përzgjedhjes, Përshkrimet e Punës
Ngritje kapacitetesh

- Në fushën e AK
- Menaxhim Projektsh
- Menaxhim Zyre
- Teknologji Informacioni

Zyra dhe pajisje të përshtatshme zyre

Detyrat Zbatimi i Strategjisë në nivel rajonal
 Dhënia e shërbimeve për PAK (sipas programit të SSSH)
 Administrimi i pagesave për PAK
 Raportimi i rregullt për Sekretariatit Teknik dhe ministrisë përkatëse të linjës

6. Njësitë e Pushtetit Vendor

Anëtarët: 12 Këshilla Rajonale, 36 Bashki, 373 Komuna: 1 pikë kontakti për AK

Varësi linje: Zyrtat rajonale të SSSH, Pikat e kontaktit në Ministri, Sekretariati Teknik

Nevojat: Kriteria përzgjedhjeje dhe përshkrime pune
Ngritje kapacitetesh:

- Në të gjitha aspektet e aftësisë së kufizuar me theks mbi shërbimet dhe zgjidhjet ligjore, përshtatshmërinë mjedisore, punësimin, arsimimin dhe kualifikimin profesional për AK
- Menaxhimin e projekteve
- Menaxhimin e zyrës dhe kontakteve
- Menaxhimin e teknologjisë së informacionit
- Anglishten

Detyrat: Zbatimi i Strategjisë
 Raportimi tek zyrtat rajonale të SSSH
 Kujdesi për publikun dhe orientimi i tij
 Mbledhje të rregullta konsultative me OJQ-të e personave me aftësi të kufizuara